

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E MAMUSHËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	626-20-6531-5-2-1
Nr i brendshëm	626-20-028-5-2-1

Sa i përket tenderit për

**Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike përgjat rrugës
Kültür në Mamushë**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Grupi i operatorve ekonomik : "VISAR KUÇI B.I" : "NAZIM SHABANAJ B.I: "N.N.SH.CO-ING"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

W. QEROILLI NR.51 SUHAREKË

(Adresa)

SUHAREKË

(Vendi)

+383 49 112211

(Numri Telefonit)

23000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

VISAR KUÇI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ntpnthesar@outlook.com

(Adresa elektronike)

29.11.2020

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Handwritten signature and initials)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kritëri për dhënie të kontratës].

B05 Njoftim per Kontrat 20.10.2020
B12 Proces verbal i hapjes se tenderave 30.10.2020
B58 Njoftim mbi vendimin e AK-s 23.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Nenet e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092:

- **Neni 1:** Qellimi
- **Neni 6:** Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- **Neni 7:** Barazia në trajtim/jo-diskriminimi
- **Neni 59:** Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- **Neni 72:** Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- **Neni 27 :** RRUOPP pika 18.4
- **Neni 27:** Dosja e Tenderit LPP Neni 27 pika 4

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Kundërshtimi: AK – Kuvendi Komunal Mamushë-Zyra e Prokurimit ka propozuar tenderues të suksesshëm operatorin ekonomik i cili ka ofruar një çmim me te lartë se sa oferta e jone me një çmim prej 92 208.47 Euro derisa çmimi i ofertës tone ishte 83 581.26 Euro. ZPP ka vepruar në kundërshtim me Nenin 6.1 të LPP, pasi ka dëmtuar buxhetin e AK për shumën prej 8 627.21 Euro edhe pse oferta e jone është e përgjegjshme sepse i kemi plotësuar të gjitha kushtet të cilat janë të cekura në njoftimin për kontratë të publikuar me datë 20.10.2020.

Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi:

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Kundërshtimi: AK – K.K.Mamushë-ZPP ka vepruar në kundërshtim të plote me këtë nen, duke na eliminuar neve si OE ku duke u bazuar në njoftimin për kontratë të datës

20.10.2020 jemi te pergjegjshem ne te gjitha kerkesat te cilat janë te cekura .

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Kundershtim: Komisioni vlersues i AK-K.K.Mamushë dhe ZPP nuk e kanë respektuar ket nen per te gjithë OE qe kan ofertuar ne kete dosje tenderuese pikerisht te ne nuk e kan respektuar as nuk na kan kerkuar asnje sqarim shtes per dokumentat te cilat janë te cekura me poshtë duke pasur parasysh qe jemi me qmim me te lirë se sa OE i shpallur fitues .Ndersa per OE tjere qe kan marrur pjes ne ket dosje tenderuese kanë kerkuar sqarime shtesë ,ndihemi te diskriminuar ne ket nen sipas AK apo Komisionit vlersues se pasi qe pretendimi i tyre per elimin thotë ju jeni eliminuar per shkak se nuk keni ofruar planin dinamik ku te njoftimi per kontrat nuk egziston kjo kerkesë per te plotsuar si kriter por vetem ceket afatet per perfundimin e punimeve ku thote.

Arsyeja se pse ne jemi Eliminuar nga ky projekt nga AK-Kuvendi komunal Mamush - ZPP/komisioni vlersues nuk qendron dhe nuk pajtohem ne si OE Qe jemi me qmim me te ulët prej 8 627.21 Euro se sa OE i rekomanduar si fitues per arsyen se nuk kem ofruar“ Plani dinamik per perfundimin e projektit ne afat prej 30 dite pune nga data e marrjes se urdherblerjes nga autoriteti kontraktues.

Ne si OE duke u bazuar ne RRUOPP Nenin 27 pika 18.4 LPP Neni 27 pika 4 ku thotë **Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike.**

Kundershtim : Duke u bazuar ne Njoftimin per Kontrat te publikuar me daten 20.10.2020 nga AK-Kuvendi Komunal Mamush-ZPP te pjesa II.3 Kohzgjatja e kontrates apo afatet kohore per perfundimin -thotë qe prej 30 ditë nga dhenja e kontrates Kohzgjatja Fillimi apo Perfundimi.Nuk thotë askundë qe me plotsu me naj dokument apo me plan dinamik ket kerkesë .Ne si OE qe kemi aplikuar ne kete dosje tenderuese jemi ne dijeni qe ky projekt pas nenshkrimit te kontrates punet kanë me perfundu ne afat prej 30 dite qe ne ket rast ZPP-K.K.Mamush ka mundur ta shfrytzoj •Neni72:Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.qe para kontrates ta sjellim ketë dokument per tju deshmuar qe ne si OE mundemi me i perfundu keto punë ne afte te cekur sipas Njoftimit per kontratë.Po ashtu duke u bazuar ne thenjen e cekur ne Njoftimin per kontrat apo dosjes se tenderit ku thotë nga marrja e urdherblerjes nga Autoriteti Kontraktues NE si OE tenderues nuk jemi ne dijeni te sakt se me qfar date do te nenshkruhet kontrata qe ket dokument ta plotsojm me data te sakta per fillimin ose perfundimin e puneve sepse urdherblerja behet pas nenshkrimit te kontrates apo me nenshkrimin e saj .

Kerkojm nga ju si ZPP i kuvendit komunal mamush qe keto pretendime tona ti analizoje duke u bazuar ne nenet apo ligjet e prokurimit qe mos të na diskreminoj neve si OE tenderues ndaj OE pjesmarres ne ket projekt . Duke u Bazuar ne keto nene ligje ne do ti kerkojm te drejtat tona nese eshte nevoja edhe ne institucione tjera kopetente per ketë procedur .

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

4/3

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*